



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I QARKUT VLORË

VENDIM

Nr 11 datë 10 / 05 / 2016

Mbi caktimin e nivelit të pagave për punonjësit e administratës të Këshillit të Qarkut

Këshilli i Qarkut Vlorë i mbledhur sot në datën e sipërcituar, pasi mori në shqyrtim materialin e paraqitur nga Këshilltari Ligjor dhe Drejtoria Ekonomike për ndryshimin e pagave të punonjësve, në mbështetje dhe në zbatim të nenit 77, pika ç, të ligjit 139/2015, dt.17.12.2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", si dhe në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.165 datë 02.03.2016 "Për grupimin e njësive të qeversjes vendore për efekt page ,dhe caktimine kufijeve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar të punonjsëve administrativë të njësive të qeversisjes Vendore" pika 1 gërma e, niveli i pagave për funksionarët e zgjedhur për këshillin e Qarkut, pika 11 paragrafi i tretë dhe katër , pika 14 dhe pika 4, lidhja nr 7, nivelet e pagave për nënpunësit civilë në "Këshillin e Qarkut".

VENDOSI:

1. Të caktojë pagat në zbatim të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.165 dt. 02.03.2016 në Aparatin e Këshillit të Qarkut si vijon:

Nr	Emërtimi	Kategoria	Nr.punonjesve	Paga e pozicionit
1	Kryetari		1	140.000
2	Zv. Kryetari		1	95.000
3	Sekretari i Këshillit të Qarkut	I-b	1	83.000
4	Drejtori i Kabinetit	I-b	1	83.000
5	Zëdhënës i Kryetarit	II-b	1	72.000
6	Këshilltari Ligjor i Kryetarit	II-b	1	72.000
7	Këshilltar për marrëdhëniet me Jashtë	II-b	1	64.000
8	Këshilltar për marrëdhëniet e brendshme	II-b	1	61.000
9	Drejtor drejtorie	II-b	1	74.400
10	Specialist	III-b	4	53.500
		Gjithsej Punonjës	13	

2. Fondi i pagave do të përballohet nga buxheti i planifikuar për vitin 2016 për shpenzime personeli.